



# **BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS**

Prill 2023

# BULETINI I KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Prill 2023

## AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

**(Në këtë edicion të këtij Buletini pasqyrohen  
aktivitetet për muajin prill të vitit 2023)**

### Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike viziton Prokurorinë Themelore në Mitrovicë

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të Strategjisë së sistemit prokurorial (2022-2024) dhe Planit të veprimit, Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, ka vizituar Prokurorinë Themelore të Mitrovicës, ku janë pritur në takim nga Kryeprokurori Ismet Ujkani dhe prokurorët e kësaj prokurorie.



Qëllimi i takimit ishte diskutimi lidhur me kryerjen e lëndëve të korrupsionit dhe krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat e ndryshme të kësaj prokurorie për trajtimin e këtyre lëndëve.

Gjithashtu, Komisioni shqyrtoi Raportin tremujor për periudhën janar-mars 2023, me ç'rast vlerësoi rezultatet e arritura në këtë prokurori, duke kërkuar që të vazhdojë angazhimi dhe përkushtimi për trajtimin e lëndëve të vitit 2022 edhe atyre të vitit 2023.

### Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës ndaj deklaratave të zyrtarëve të lartë shtetërorë të Lëvizjes Vetëvendosje

Këshilli Prokurorial i Kosovës kundërshton fuqishëm dhe shpreh indignatë të thellë ndaj deklaratave të

deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe përfaqësuesve të lartë të Lëvizjes Vetëvendosje, të cilët kanë përdorur gjuhë të papranueshme dhe tendencioze lidhur me punën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), z. Blerim Isufaj.



KPK-ja konstaton se disa zyrtarë të lartë shtetërorë po tentojnë të ndikojnë sistematikisht në punët e sistemit prokurorial dhe po përçojnë mesazhe tendencioze politike, sikurse që kanë bërë edhe kësaj radhe, duke përdorur gjuhë denigruese kundër personalitetit të kandidatit për Kryeprokuror të Shtetit, z. Blerim Isufaj, gjë që është në kundërshtim me të gjitha normat etike, ligjore dhe kushtetuese.

Këshilli Prokurorial vlerëson se, deklaratat e tilla, siç ishin ato të djeshmet, janë në kundërshtim të plotë me ndarjen e pushteteve dhe përbëjnë ndërhyrje flagrante dhe të drejtpërdrejta në punën e Gjyqësorit, përkatësisht të institucionit të Prokurorit të Shtetit, ngaqë puna dhe angazhimi i të gjithave, përfshirë edhe PSRK-në, burojnë nga Kushtetuta dhe ligjet e vendit, e jo nga vullnetet politike, grupet e interesit dhe individët e caktuar.

Me këtë rast, Këshilli Prokurorial, thekson se qëndron plotësisht prapa punës së mirëfilltë dhe shumë profesionale të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës dhe prapa punës dhe angazhimit të prokurorëve të PSRK-së dhe në asnjë rast nuk do të tolerojë denigrimet dhe atakimet qëllimkëqija ndaj angazhimeve dhe përkushtimit të bartësve të sistemit prokurorial.

Në përmbyllje të këtij reagimi, KPK-ja ia risjellë në vëmendje kujtdo që tenton të cenojë punën e kësaj prokurorie dhe Kryeprokurorit të saj, z. Blerim Isufaj, si dhe përgjithësisht punën e institucionit të Prokurorit të Shtetit se, pushteti gjyqësor dhe prokurorial është i veçantë, me institucione kushtetuese, të pavarura dhe të paanshme, të cilat kryejnë detyrën e tyre në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor, duke u bazuar gjithnjë në prova dhe fakte.

## Mbahet Takimi i 229-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës, i udhëhequr nga Kryesuesi Jetish Maloku, mbajti Takimin e 229-të me radhë, në të cilën kishte vetëm një pikë të rendit të ditës.



Me këtë rast, KPK-ja themeloi panelin hetimor për rastin disiplinor ndaj një prokuroreje të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të cilin e ka kërkuar autoriteti kompetent.

## Urimi i Kryesuesit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, me rastin e Festës së Fitër Bajramit

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Jetish Maloku, me rastin e festës së Fitër Bajramit, ju dërgon urimet më të mira të gjithë besimtarëve myslimanë, duke uruar që kjo festë t'ju sjellë gëzime, begati dhe paqe në familjet dhe në shoqërinë tuaj.



## Deklaratë e Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me debatet e zhvilluara në Kuvendin e Kosovës

Këshilli Prokurorial i Kosovës, lidhur me diskutimet e zhvilluara gjatë ditës së sotme në Kuvendin e Kosovës, posaçërisht nga Kryeministri i Republikës së Kosovës, që kanë të bëjnë me punën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, deklaron se, sa i përket rastit të tanimë të ndjerit z. Dino Asanaj, informojmë opinion se janë ndërmarrë të

gjitha veprime e nevojshme hetimore dhe procedurale nga ana e prokurorit të çështjes dhe pas vlerësimit të gjendjes faktike është dhënë informacioni në kohë reale lidhur me këtë rast.

KPK-ja thekson se për hir të transparencës para opinionit publik dhe në zbatim të ligjit, fton këdo që ka informacione të tjera lidhur me këtë rast, përfshirë edhe vetë Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ministrat dhe deputetët e Kuvendit, si dhe zyrtarët e tjerë shtetërorë dhe qytetarët e vendit, që të vijë dhe të ofrojnë informacionet lidhur me këtë rast pikërisht në institucionin ku është vendi të jepen detajet që mund të jenë të panjohura deri tashti.



KPK-ja thekson se institucionet prokuroriale janë të gatshme plotësisht dhe të përkushtuara që ligjërisht të trajtojnë secilin informacion me interes për ndriçimin e të gjitha rasteve në fjalë.

Rrjedhimisht, Këshilli Prokurorial i Kosovës, informon publikun e gjerë se, sa i përket rastit “Sopa”, është e vërtetë që tashmë Kryeprokurori i PSRK-së, z.Blerim Isufaj, ishte prokuror i rastit në fazën fillestare të hetimeve, porse ju informojmë se ndërkohë këtë rast e ka marrë në trajtim një prokuror tjetër dhe është mirë që të pyetet prokurori i rastit, sepse vetëm ai mund të japë përgjigje adekuate.

Gjithashtu, KPK-ja demanton deklaratat e pavërteta se ka pasur raste edhe me herët por kinse nuk janë ka trajtuar, pra kjo deklaratë rezulton të jetë e pavërtetë dhe natyrisht se edhe për këtë rast, nëse ka informata të tilla, le ta deklarohen ato publikisht dhe të dihet se cili rast ishte dhe kush e ka trajtuar atë.

KPK-ja deklaron se mbështet dhe mbron me të gjitha mjetet juridike në dispozicion punën profesionale të të gjithë prokurorëve të Republikës së Kosovës dhe në këtë rast edhe punën e PRSK-së dhe të prokurorëve të saj, të cilët angazhohen dhe punojnë që të zbatohen ligjet e vendit dhe që të mos atakohen pa fakte në çdo situatë dhe për agjenda që nuk janë në domenin e institucionit të Prokurorit të Shtetit.

## Reagim i Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me shkrimet e publikuara në rrjete sociale nga drejtori i mediumit “Nacionale”, Berat Buzhala

Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), reagon ndaj gjuhës fyese dhe shpifëse që po përdoret tash e një kohë nga drejtori i mediumit “Nacionale”, Berat Buzhala, ndaj Ushtruesit të Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi.

Këshilli Prokurorial, thekson se me anë të shpifjeve, drejtori i “Nacionale”-s po tenton të njollosë pa të drejtë personalitetin, integritetin dhe profesionalizmin e U.D. Kryeprokurorit Kelmendi.

Këshilli Prokurorial i Kosovës, thekson se kjo seri e shkrimeve hyn në radhën e shpifjeve qëllimkëqija ndaj U.D. Kryeprokurorit të Shtetit, sepse është fakt i njohur se punëtorët shqiptarë të administratës në gjykata dhe prokurori të cilës i përkiste edhe z. Kelmendi, kanë punuar në bazë të kërkesës së subjekteve politike shqiptare të asaj kohe, ku rolin kryesor e kishte Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke qenë kështu në shërbim të plotë të kauzës gjithëpopullore të asaj kohe për liri dhe pavarësi nga regjimi serb.



Për më tepër, KPK-ja thekson, siç ka potencuar edhe herëve të tjera, se U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi është vendosur në këtë detyrë si rezultat i vlerësimit dhe i përkrahjes së të gjithë anëtarëve të KPK-së, për të ushtruar këtë detyrë deri në dekretimin e Kryeprokurorit të ri Shtetit, me ç’rast është vlerësuar integriteti dhe pastërtia e figurës së tij. Për hir të korrektësisë, U.D. Kryeprokurori Kelmendi nuk ka kandiduar fare për pozitën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe nuk ka synime të tilla.

Këshilli Prokurorial, me këtë rast, vlerëson se në bazë të kësaj çfarë ka shkruar gazetari Buzhala ekziston një tendencë për të përçarë sistemin prokurorial, por këto përpjekje do të dështojnë, sepse KPK-ja dhe institucioni i Prokurorit të Shtetit janë unikë në ushtrimin e detyrave kushtetuese dhe të pa kompromis në forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës.

KPK ia bënë me dije opinionit publik se U.D. Kryeprokurori i Shtetit do të shfrytëzojë rrugët ligjore për t'iu drejtuar gjykatës kompetente me padi për shpifjet e bëra nga drejtori i gazetës "Nacionale".

## Finalizohet drafti i Rregullores për Shtesat dhe Kompensimet në Sistemin Prokurorial

Komisioni për Çështje Normative, i udhëhequr nga anëtari i Këshillit Prokurorial të Kosovës, prokurori Armend Zenelaj, ka mbajtur takimin e radhës, në të cilin ka finalizuar draftin e Rregullores për shtesat dhe kompensimet për prokurorët e shtetit dhe të punësuarit e sistemit prokurorial.

Në këtë draft parashihet rregullimi i shtesave dhe kompensimeve për prokurorët e shtetit, anëtarëve të Këshillit dhe të trupave të tij, si dhe për të punësuarit në sistemin prokurorial, në bazë të të cilit përcaktohen kriteret, kushtet, rregullat, mënyra e llogaritjes dhe procedura për përfitimin e këtyre shtesave dhe kompensimeve.



Pas përfundimit të këtij drafti, anëtarët e këtij komisioni propozuan që i njëjti të dërgohet për miratim në takimin e radhës së Këshillit Prokurorial të Kosovës.

## Komisioni Mbikëqyrës për Monitorimin e Rasteve të Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike viziton Prokurorinë Themelore në Gjakovë

Komisioni Mbikëqyrës për Lëndët e Korrupsionit dhe Krimeve Ekonomike, i udhëhequr nga kryesuesi Arian Gashi, së bashku me anëtarët e këtij Komisioni, prokurorët Arben Ismajli dhe Laura Pula, si dhe Koordinatorin e Komisioneve të Përhershme të KPK-së, Besim Kusari, ka vizituar Prokurorinë Themelore të Gjakovës, ku janë pritur në takim nga U.D. Kryeprokurori i kësaj prokurorie, Enis Gashi.



Takimi u zhvillua në kuadër të monitorimit aktiv të zbatimit të Strategjisë së sistemit prokurorial (2022-2024) dhe Planit të veprimit nga ana e këtij komisioni, me ç'rast është diskutuar për procesin e kryerjes së lëndëve të korrupsionit dhe të krimeve ekonomike, trajtimin e tyre dhe sfidat që paraqesin ato në këtë prokurori.

Anëtarët e Komisionit, gjatë shqyrtimit të Raportit tremujor për periudhën janar-mars 2023, vlerësuan rezultatet në këtë prokurori dhe, njëkohësisht, kërkuan përkushtim të mëtejshëm për trajtimin e lëndëve të vitit 2022 edhe lëndëve pasuese të vitit 2023.

## Aktivitetet e Sekretariatit të KPK-së

Sekretariatit të KPK-së, gjatë muajit prill, ka dhënë kontribut profesional në kuadër të projektit për zhvillimin dhe dizajnimin e uebportalit të sistemit prokurorial të Kosovës dhe ka mbajtur një takim me përfaqësuesit e UNDP-së për zhvillimin e sistemit elektronik e-biblioteka.

Gjithashtu është mbajtur trajnimi shtesë për stafin e trajnerëve për përdorimin e modulit të ankesës në SMIL, i cili është zhvilluar dhe mundëson regjistrimin e të gjitha ankesave, të pranuar fillimisht në instancën e parë dhe të dytë dhe janë mbajtur trajnime për zyrtarët ligjorë dhe bashkëpunëtorët profesionalë në ZKPSH për përdorimin e SMIL-it.

SKPK-ja ka përgatitur raporti financiar për periudhën janar-mars 2023 dhe ka publikuar versionin e sistemit elektronik për menaxhimin e takimeve dhe dokumenteve të Këshillit Prokurorial të Kosovës (E-Këshilli), si dhe ka marrë pjesë aktive dhe mbështetëse në mbrojtje të votës së lirë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetarë të katër komunave dhe për këshilltarw në dy prej atyre komunave.